

## GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës:                   **PAKR 441/13**

Më:                                   **2 prill 2014**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare dhe gjyqtarët kosovarë të Gjykatës së Apelit Vahid Halili dhe Mejreme Mema, anëtarë të kolegjit me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Beti Hohler,

Në procedurën penale kundër

**A.R.**, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx emri i babait **V**, emri i nënës **Z**. (e gjinisë **K.**), aktualisht me vendbanim në rrugën xxx, shqiptar kosovar, me numër të letërnjoftimit xxx;

*I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin nr. P 86/13 të Gjykatës Themelore të Pejës, të datës 14 qershor 2013 për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në bazë të neneve 3 (2), 31 dhe 422 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Ligjit nr. 04/L-082 (KPRK të vitit 2013);*

**Duke vendosur rreth ankesave në vazhdim të ushtruara kundër aktgjykimit nr. P 86 / 13 të Gjykatës Themelore të Pejës, të datës 14.06.2013 (më tutje në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar):**

- **Ankesa e të pandehurit A.R., e parashtruar më 26 korrik 2013,**
- **Ankesa e avokatit mbrojtës Bajram Tmava për të pandehurin A.R., e ushtruar më 26 korrik 2013;**

*Pas rishikimit të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit nr. PPA/I 404/13 të datës 19.11.2013, të paraqitur pranë Gjykatës së Apelit më 20 nëntor 2013;*

*Pas mbajtjes së seancës publike më 2 prill 2014 në praninë e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës Bajram Tmava dhe prokurorit të apelit të shtetit Xhevdet Bislimi;*

*Pas këshillimit dhe votimit më 2 prill 2014;*

*Në bazë të neneve 389, 390, 394, 398 të Kodit të Procedurës Penale – Ligjit nr. 04/L-123 (KPP);*

*Sjell këtë:*

## AKTGJYKIM

---

Ankesa e të pandehurit **A.R.** dhe ankesa e avokatit mbrojtës **Bajram Tmava**, të dyja të parashtruara më datën 26 korrik 2013 kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Pejës nr. P 86 / 13, të datës 14 qershor 2013, pranohen pjesërisht.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Pejës nr. P 86/13 i datës 14 qershor 2013 ndryshohet si më poshtë:

“Refuzohet akuza e *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit* (aktakuza e PSRK-së nr. PPS 07/11 e datës 23.07.2012) ndaj **A.R.**

Shpenzimet e procedurës penale në bazë të nenit 450 (2) 2.1 deri në 2.5) të KPP-së, shpenzimet e nevojshme për të pandehurin **A. R.** dhe shpërblimet dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit paguhen nga burimet buxhetore”

### ARSYETIM

#### **I. Procedura e deritanishme e kësaj lënde**

1. Prokurori i shtetit më 23 korrik 2012 ka parashtruar aktakuzën nr. PPS 07/2011 pranë ish Gjykatës së Qarkut të Pejës. Aktakuza është ngritur ndaj të pandehurit **K.P.** dhe të pandehurit **A.R.**. Aktakuza ndaj **A.R.** është ngritur për veprën penale të *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit* sipas nenit 339, par. (1), lidhur me par. (3) të Kodit Penale të Kosovës (KPK),<sup>1</sup> në bashkëryerje me të pandehurin **K.P.** sipas nenit 23 të KPK-së, lidhur me veprën penale *keqpërdorim i besimit* sipas nenit 269, par. (1), lidhur me par. (2) të KPK-së.

2. Gjyqtari konfirmues i Gjykatës së Qarkut të Pejës më 20 shtator 2012 ka marrë aktvendimin nr. KA 223/12. Gjyqtari konfirmues ka vërtetuar aktakuzën për të dy të pandehurit (**K.P.** dhe **A.R.**) për veprën penale *keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit* sipas nenit 339, par. (1) dhe (2) të KPK-së. Gjyqtari konfirmues ka hedhur poshtë aktakuzën ndaj dy të pandehurve për veprën penale të *keqpërdorimit të besimit* sipas nenit 269, par. (1) dhe (2) të KPK-së, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit për ndjekje të veprës penale.

3. Shqyrtimi gjyqësor kundër të pandehurit **A.R.** ka filluar para trupit gjykues të Gjykatës Themelore të Pejës më datën 29 janar 2013. Seancat e mëtejshme janë mbajtur më 30 janar 2013, më 4 shkurt 2013, më 10 prill 2013 dhe më 10 qershor 2013. Më 14 qershor 2013, trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin për lëndën në fjalë.

---

<sup>1</sup> Kodi Penal në fuqi në Kosovë nga data 6.04.2004 deri më 31.12.2012.

4. Trupi gjykues ka shpallur fajtor të pandehurin **A.R.** fajtor për veprën penale të *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit* në bazë të nenit 422, par. (1) të KPRK-së të vitit 2013 dhe e ka dënuar me burgim prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh. Trupi gjykues më tutje e ka urdhëruar të pandehurin të paguajë shumën e parave e cila përputhet me dobinë pasurore të 71.257,40 EUR. Trupi gjykues po ashtu e ka urdhëruar të pandehurin **A.R.** që t'i mbulojë shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 700 eurosh. Palët e dëmtuara janë udhëzuar të paraqesin kërkesë pasurore juridike përmes gjykatave civile.

5. Gjykata e Apelit ka para vetes dy ankesa të parashtruara nga i pandehuri dhe avokati mbrojtës i të pandehurit, kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

6. Gjykata e Apelit ka mbajtur seancën publike lidhur me lëndën në fjalë më 2 prill 2014 në praninë e të pandehurit, avokatit mbrojtës dhe prokurorit të apelit të shtetit.

## **II. Parashtrës të palëve**

*(Ankesat)*

7. I pandehuri **A.R.** ka parashtruar ankesë më 26 korrik 2013 për arsye të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penal, vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike. I pandehuri po ashtu ka kundërshtuar vendimin mbi dënimin penal dhe kërkesën civile pasurore juridike. Ai ka propozuar që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta shpallë atë të pafajshëm.

8. Avokati mbrojtës Bajram Tmava më 26 korrik 2013 ka parashtruar ankesën e datës 22 korrik 2013 pranë Gjykatës Themelore për arsye të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin. Ai ka kërkuar nga Gjykata e Apelit ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar duke e shpallur të pandehurin të pafajshëm dhe duke e liruar nga akuzat sepse vepra për të cilën është akuzuar nuk përbën vepër penale (neni 364 (1), nënpar. (1.1) i KPP-së).

*(përgjigjja e prokurorit)*

9. Prokurori i rastit nuk ka parashtruar përgjigjen ndaj këtyre ankesave.

*(Propozimi i prokurorit të apelit të shtetit)*

10. Prokurori i apelit i shtetit në propozimin e vet të datës 19 nëntor 2013 i propozon Gjykatës së Apelit refuzimin si të pabaza të ankesave të të pandehurit dhe mbrojtësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Pejës.

## **III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

11. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur rreth ankesave sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat – Ligjit nr. 03/L-199.

12. Kolegji i Gjykatës së Apelit është i përbërë në bazë të nenit 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligjit nr. 03/L-053. Në bazë të vendimit të kryetarit të asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2014 OPEJ 0128 - 0001 të datës 12 mars 2014, të marrë në pajtim me nenin 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ka qenë i përbërë nga një gjyqtar i EULEX-it dhe dy gjyqtarë kosovarë të Gjykatës së Apelit. Palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e kolegjit.

13. Ankesat e mbrojtjes janë parashtruar me kohë dhe janë të pranueshme. Këto ankesa të mbrojtjes pranohen pjesërisht.

14. Gjykata Themelore ka shpallur të pandehurin fajtor për kryerjen e veprës penale të *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit* në bazë të nenit 422, par. (1) të KPRK-së të vitit 2013. Gjykata Themelore e ka zbatuar kodin e ri penal të Kosovës si ligj më i favorshëm për të pandehurin në përputhje me nenin 3, par. (2) të KPRK-së.

15. Gjykata e Apelit e vërteton vlerësimin e Gjykatës Themelore se kodi i ri penal është më i favorshëm për të pandehurin në këtë lëndë prandaj është ligj i zbatuar.

16. Gjykata e Apelit pajtohet me argumentet e mbrojtjes të ngritura në ankesa dhe pajtohet se Gjykata Themelore nuk është dashur ta dënonte të pandehurin por ta lironte përmes gjetjeve të sakta lidhur me faktet dhe ligjin penal. Kolegji në veçanti është i shqetësuar rreth përfundimit të Gjykatës Themelore se i pandehuri, edhe pse nuk është person zyrtar, mund të ndiqet penalisht për veprën penale të *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit*, për arsye se bashkëkryerësi i pohuar (**K.P.**) ka qenë person zyrtar. Ky është lajthim i rëndë juridik të cilin mbrojtja me të drejtë e thekson. Për t'u ndjekur dhe dënuar i pandehuri për veprë penale si *kryerës*<sup>2</sup> duhet patjetër të vërtetohen të gjitha elementet e veprës penale të pohuar. I pandehuri, duke ushtruar rolin e vet si xxx, nuk ka qenë person zyrtar, porse ky element mungon dhe i pandehuri ligjërisht nuk mund të konstatohet përgjegjës si kryerës i veprës penale të *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit* ose i veprave të ngjashme penale, në të cilat statusi i personit zyrtar është prej elementeve të krimit. Kolegji megjithatë nuk ka nevojë të futet në detaje të tjera lidhur me këtë lëndë, për shkak se ndjekja e veprës penale ndalohet me parashkrim.

17. Gjykata e Apelit pajtohet me qëndrimin e mbrojtjes lidhur me skadimin e afatit të parashkrimit, i cili tashmë është ngritur gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kjo shpie tek rezultati se

---

<sup>2</sup> Konkluzioni mund të jetë tjetër po qe se i pandehuri akuzohet me ndonjë përgjegjësi tjetër, p.sh. dhënie të ndihmës apo shtytje.

Gjykata Themelore është dashur ta refuzojë akuzën ndaj të pandehurit – d.m.th. ta marrë aktgjykimin refuzues në bazë të nenit 363 të KPP-së.

18. Dënimi i përcaktuar për veprën penale nga neni 422, par. (1) i KPRK-së është burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Në bazë të nenit 106, par. (1), nënpar. (1.4) të KPRK-së të vitit 2013, afati i parashkrimit për këtë vepër penale, duke u bazuar në dënimet maksimale të përcaktuara është pesë vjet.

19. Neni 107, par. (1) i KPRK-së përcakton që afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Në bazë të aktakuzës nr. PPS 07/2011 të datës dhe të ngritur më 23 korrik 2012, i pandehuri pohohet se kishte kryer veprën penale më 14 qershor 2005.<sup>3</sup> Për këtë arsye, afati i parashkrimit për fillimin e ndjekjes ka skaduar pesë vjet pas asaj date, d.m.th. më 14 qershor 2010.

20. **Z. M.**<sup>4</sup> lidhur me lëndën në fjalë ka paraqitur kallëzim penal më datën 5 janar 2011.<sup>5</sup> Prokurori ka marrë aktvendimin mbi fillimin e hetimeve ndaj **A.R.t** më datën 16 shkurt 2011.

21. Kolegji e vëren se më datën 4 shkurt 2011 prokurori tashmë e kishte zhvilluar një intervistë me **Z. M.** lidhur me kallëzimin penal të cilin e kishte paraqitur ndaj të pandehurve **P.** dhe **R.**<sup>6</sup> Sipas nenit 107, par. (5) të KPRK-së të vitit 2013, afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret me qëllim të ndjekjes së veprës penale të kryer. Kolegji konsideron se marrja në pyetje e personit i cili ka paraqitur kallëzim penal ka qenë veprim i ndërmarrë me qëllim të ndjekjes penale dhe prandaj ky veprim e ka ndërprerë parashkrimin dhe jo lëshimin e aktvendimit mbi fillim të hetimeve. Për këtë arsye, data relevante për t'u marrë parasysh si fillim i çdo veprimi të ndjekjes penale është data 4 shkurt 2011.

22. Gjykata e Apelit konstaton se veprimi i parë i ndjekjes penale është ndërmarrë më tepër sesa gjashtë muaj pas skadimit të afatit të parashkrimit. Afat i parashkrimit zaten ka skaduar, siç u tha më lart, më 14 qershor 2010.

23. Kolegji konstaton se në kohën kur janë filluar hetimet penale, vepra penale për të cilën fillimisht është akuzuar i pandehuri ka qenë e dënueshme me tetë vjet ndërsa afati i parashkrimit

---

<sup>3</sup> Shih pjesën akuzuese të aktakuzës nr. PPS 07/2011 të datës dhe të ngritur më 23 korrik 2012, faqe 5.

<sup>4</sup> Kolegji vëren se trupi gjykues gjatë tërë procedurës gabimisht ka konsideruar se **Z.M.** është palë e dëmtuar. Ky i fundit nuk i plotëson kushtet për të qenë palë e dëmtuar në këtë procedurë penale dhe prandaj nuk e ka këtë status.

<sup>5</sup> Kolegji vëren se kallëzimi penal mban datën 28.12.2010 dhe është i vulosur me vulën e pranimit të mbushur me dorë me shkrim me datën 05.01.2010. Kolegji konsideron se duke e pasur parasysh se dokumenti është i datës 28.12.2010, në vulë është dashur të jetë e shkruar data 05.01.2011. Sipas pikëpamjes së kolegjit referimi që i bëhet vitit 2010 është gabim shtypi.

<sup>6</sup> Shih procesverbalin e seancës dëgjimore të palës së dëmtuar, PPS 07/2011, 4.02.2011, shkresat e lëndës së gjykatës, dengu nr. I, tab 31-1

ka qenë më i gjatë – duke arritur në dhjetë vjet. Për këtë arsye, në kohën kur ka nisur ndjekja penale, afati i parashkrimit nuk kishte kaluar dhe ishte ndërprerë në mënyrë të ligjshme.

24. Megjithatë, me ndryshimin në ligjin material penal, afati i parashkrimit është më i shkurtër. Ligjshmëria e ndjekjes penale duhet patjetër të vlerësohet në bazë të ligjit të tanishëm në fuqi – ligjit material penal si tërësi.

25. Gjykata Themelore, duke pasur parasysh ndryshimin në fjalë të afatit të parashkrimit, ka konsideruar çështjen në fjalë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit ka refuzuar kundërshtimin e mbrojtjes me këtë argumentim: *“Çështje me rëndësi [...] është nëse gjatë zhvillimit të kësaj lënde prokurori ka ndërmarrë apo jo ndonjë veprim i cili në mënyrë të ligjshme ka sjellë deri tek përmbyllja apo e ka ndërprerë kalimin e kohës së parashkrimit. [...] Prokurori ka marrë aktgjykimin mbi fillimin e hetimeve më 16 shkurt 2011 i cili po ashtu ka qenë brenda afatit të parashkrimit i cili ka qenë në fuqi asokohe. Pasi prokurori ka nisur ndjekjen penale në mënyrë të ligjshme, afati i vetëm relevant kufizues i cili vlen për trupin gjykues është ndalimi absolut i cili përcaktohet me nenin 107, par. 8.”*<sup>7</sup>

26. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore.

27. Gjykata e Apelit gjen se kur ka ndonjë ndryshim në ligjin material, siç është rasti në fjalë, gjykata obligohet të vlerësojë nëse ndjekja penale ka filluar në mënyrë të ligjshme në bazë të *ligjit të tanishëm në fuqi*. Në qoftë se kjo do të thotë se ndjekja penale nuk ka filluar me kohë, akuza duhet patjetër të refuzohet.

28. Afati i parashkrimit është i bazuar në gjatësinë e dënimit maksimal të përcaktuar. Ulja e dënimit të përshkruar, siç është në rastin tonë, mund të rezultojë në afat më të shkurtër të parashkrimit. Ligji në përgjithësi duhet domosdo të zbatohet për të pandehurin, d.m.th. edhe ndryshimi në afatin e parashkrimit.<sup>8</sup>

29. Gjykata e Apelit prandaj gjen se kishte kaluar afati i parashkrimit për ndjekjen penale ndaj të pandehurit dhe akuza ndaj të pandehurit është dashur të refuzohet nga Gjykata Themelore përmes aktgjykimit refuzues të përcaktuar me nenin 363, par. (1.3.) të KPP-së.

30. Gjykata e Apelit në bazë të nenit 398, par. (1), nënpar. (1.4.) të KPP-së, prandaj e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar dhe e refuzon akuzën ndaj **A.R.**

---

<sup>7</sup> Aktvendimi i trupit gjykues i marrë në shqyrtimin gjyqësor, në seancën e datës 29 janar 2013. Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor, të datës 29.01.2013, faqet 5 - 6.

<sup>8</sup> Konkluzioni i njëjtë është arritur edhe jurisprudencën e krahasuar. Shih p.sh. vendimin e Gjykatës Supreme Federale të Gjermanisë, lënda nr. BGH 2 StR 122/05, e datës 07.06.2005.

31. Pas ndryshimit të aktgjykimit të kundërshtuar dhe pas refuzimit të akuzës ndaj të pandehurit, kolegji në bazë të nenit 454, par. (1) të KPP-së po ashtu e ndryshon aktvendimin mbi shpenzimet ashtu që shpenzimet e kësaj procedure penale të mbulohen nga burimet buxhetore.

32. Kolegji më tutje e sqaron se i tërë dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar kthehet prapa për t'u ndryshuar, duke përfshirë këtu vendimin mbi pagesën e shumës prej 71.257,40 eurosh.

33. Për këtë arsye, vendoset si në dispozitiv.

*Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar.*

*Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më datën 28.04.2014.*

Kryetarja e kolegjit

---

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

---

Mejreme Mema

gjyqtare

Anëtari i kolegjit

---

Vahid Halili

gjyqtar

Zyrtarja ligjore

---

Beti Hohler  
Zyrtare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Pakr 441/13**

**02.04.2014**